

KONTRATE THEMELIMI

E

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Vela Group” Shpk

Në Tirane, sot me datë 10.09.2021, ne:

1. **Illir Mitrushi** i biri i Mirilit, i datëlindjes 17.06.1966, me pashaportë 527342724, lindur në Berat dhe banues në Korce, ne adresen Rruga “Evanthi Dvorani” “6/1, Lagja 12
2. **Dritan Vreshta**, i biri i Sami, i datelindjes 10.06.1977 me karte identiteti 034343208, lindur ne Pulahe dhe banues ne Tirane, ne adresen rruga e Ationit, Pallati nr 3, Apartamenti 48.
3. **Russell Grant Van Cleve**, i biri i Russell, i datelindjes 30.12.1968 me pasaporte amerikane me nr. 597459931, lindur ne Ohio, USA dhe banues ne California, USA
4. **Migena Schröder**, e bija e Lefter Klemo, e date lindjes 28.05.1975 me karte identiteti L1CC4Y76Z, lindur ne Tirane dhe banues ne Zug, Zvicër.
5. **EUROCON blue GmbH**, rregjistruar ne Kiel, Gjermani me nr identifikim HRB 15108 KI, me adres Im Brauereiviertel 5, 24118 Kiel, Gjermani; i cili perfaqesote nga Axel Joerg Schulz, i biri i Harald Otto Gustav Schulz, i date lindjes 12.04.1968 me pasaporte gjermane me nr C1KV8TMLN, lindur dhe banues ne Kiel, Gjermani.

Ne baze te vullnetit tone te lire dhe mbeshtetur ne Ligjin 9901 date.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar, dhe vecanerisht neni pika 2, dhe ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” vendosëm të themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që do të veprojë sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqerise është “Vela Group” Shpk

Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brëndshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri “Vela Group” Sh.p.k, sipas përcaktimeve të bëra në këtë AktThemelimi si dhe në Statutin vijues.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktiviteti ekonomik në fusha të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në vijim në këtë kontratë si dhe në Statutin e saj. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.



1



Korrigjimi është bërë sipas origjinalit

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “Vela Group” Sh.p.k. Ajo do të ketë edhe vulën e saj me po këtë emër.

NENI 4

Objekti veprimtarise

Shoqëria ka si objekte veprimtarie të saj aktivitetet që paraqiten në vijim:

a. Kryerjen e aktivitetit të formimit dhe edukimit profesional në fushën e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikacioneve, përgatitje, zhvillim, shitje dhe blerje programesh kompjuterike, dhe aktivitete të tjera të lidhura me ekonominë Digjitale.

b. Shërbime për zhvillim programesh, stafesh të specializuara në fushën e TIK dhe Inovacionit.

c. Aktivitet në fushën e prodhimit, blerjes dhe shitjes së software (programeve kompjuterike dhe zgjidhjeve teknologjike nëpërmjet programimit), dizejnim programimi (kodim) dhe zhvillim, projektim i detajuar i software dhe bazave të të dhënave, analizë, integrim i përbërësve (komponenteve), trajnime mbi produktet software, instalime, konsulenca, zbatime dhe aktivitete të tjera ndihmëse në fushën e teknologjisë dhe digjiitalizimit përtej industrisë përkatëse, ndjekje të proceseve, kolaudim, korrigjim, deri në produktin përfundimtar duke realizuar zgjidhje, plotësime të sistemit informatik me elementet e sigurisë, privatësisë etj.

d. Blerje dhe shitje të pajisjeve hardware, kompjutera, aksesore dhe pjesë të tyre, instalim e mirëmbajtje të tyre.

e. Kurse të formimit profesional, këshillim karriere, ndërmjetësim punësimi dhe shërbime të tjera të tregut të punës të lidhura kryesisht me fushën e shkencave kompjuterike dhe teknologjisë, por dhe më gjerë, në sektorë të tjerë përtej kësaj industrie.

f. Krijimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e lidhjeve profesionale midis punëdhënësve të lidhur me fushën e teknologjisë dhe informacionit dhe më gjerë si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

g. Import dhe eksport të mallrave dhe shërbimeve sipas nënpikave a.-f. të këtij neni.

h. Krijimin, këshillimin, dhe financimin e sipërmarrjeve të reja (startups).

i. Blerje pjesëmarrjeje aksionare apo jo aksionare në shoqëri të tjera, ente konsorciume, të themeluara apo në themelim, të cilat mund të kenë objekt të ngjashëm ose sidoqoftë të ndërlidhur apo plotësues të objektit të saj, apo sidoqoftë në funksion të arritjes të qëllimit të shoqërisë.



Shoqëria mund të beje ose mund të kërkojë regjistrimin në emër të saj, transferoje apo të tregtojë si të njëjta, patenta e të drejta autori, marka të ndryshme, marketingu, licenca, tituj tregtie si dhe të drejta të ngjashme intelektuale dhe industriale.

- Më në përgjithësi shoqëria do të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për përmbushjen e qëllimeve të shoqërisë

NENI 5

Selia e shoqërisë dhe afati

Selia e shoqërisë do të jete në adresën: **Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa 203, H.11, 1023, Laprakë, Tiranë, Albania**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë në vlerën 86 000 ALL (tetedhete e gjashteqind mijë lekë) dhe është i ndarë në 5 kuota


NENI 7

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare “Vela Group” Sh.p.k dhe zotërimi i kuotave nga secili në këtë shoqëri është si më poshtë

- ‘A’, **Ilir Mitrushi** i biri i Mirilit, i datëlindjes 17.06.1966, i cili zoteron 1 Kuotë me 9.3% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 7.998 lekë.
- ‘B’ **Dritan Vreshta**, i biri i Sami i date lindjes 10.06.1977, i cili zoteron 1 Kuotë me 9.3% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 7.998 lekë.
- ‘X’ **Russell Grant Van Cleve**, i biri i Russell, i cili zoteron 1 Kuotë me 29.07% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 25.000,2 lekë.
- ‘Y’ **Migena Schröder**, e bija e Lefter Klemo, e date lindjes 28.05.1975, i cili zoteron 1 Kuotë me 29.07% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 25.000,2 lekë.
- ‘Z’, **EUROCON blue GmbH**, regjistruar në Kiel, Gjermani me nr identifikim HRB 15108 KI, me adres Im Brauereiviertel 5, 24118 Kiel, Gjermani; i cili perfaqesote nga Axel Joerg Schulz, i biri i Harald Otto Gustav Schulz, i date lindjes 12.04.1968, i cili zoteron 1 Kuotë me 23.26% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 20.003,6 lekë.

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

Ortakët bien dakord që ortaku A të kryejë një shërbim për shoqërinë në rolin e administratorit dhe perfaqesuesit ligjor si dhe drejtuesit akademik dhe pedagogjik të shkollës, kurse ortaku B do të kryejë rolin e drejtuesit operativ të shkollës, Ortaku A dhe B bien dakord të plotësojnë këto detyrim



angazhimi me kompetence dhe dedikim. Asambeja do te vleresoje performancen e tyre per nje periudhe 40 mujore. Ortaku A dhe B pranon qe shoqeria te kete te drejten e blerjes se kapitalit te tij (dhe ai deklaron se do te heqe dore nga e drejta e kuotes se tij pjeserisht apo plotesisht) ne favor te shoqerise ne masen prej 1/40 per cdo muaj, bazuar ne vleresimin periodik qe do te beje asambleja e ortakeve per performancen e punes se tyre. Ne rast se ortaku A dhe B nuk plotesojne detyrimin e tyre sipas percaktimit ne kete nen atehere ata kane detyrimin dhe shoqeria ka te drejten e blerjes se kuotes se tij me vleren nominale. Shuma e kapitalit qe do te heqe dore ortaku A dhe B llogaritet pas vleresimit te asamblese me 1/40 e cdo muaji qe ka mbetur nga periudha 40 mujore e angazhimit te tyre.

Ortaku X bie dakord te mare angazhimin e tij per te kryer rolin e kryetarit te bordit per nje periudhe te pakten 40 mujore dhe ortaku Y bie dakord te marre detyren e menaxhimit te marredhenieve me investitoret e rinj, zgjerimin e biznesit dhe veprimtarine e lidhur e to, per te njejten periudhe minimale 40 mujore. Nese ortaket X, Y, nuk e plotesojne detyrimin e tyre, atehere ata detyrohen te heqin dore nga 1/5 te kuotes se tyre e kapitalit te tyre ne perpjestim me mosplotesimin e ketij detyrimi, duke ja transferuar kete pjese te kuotes se tyre shoqerise me vleren nominale.

Vleresimi i performances se ortakeve A, B, X dhe Y do te behet ne menyre periodike dhe do te jete asambleja e ortakeve te shoqerise qe do te vendose ne lidhje me terheqjen apo jo nga kuotat e kapitalit dhe masen perkatese te terheqjes te secilit prej ketyre ortakeve. Nese asambleja nuk shprehet ne menyre te drejtperdrejte atehere konsiderohet qe performanca eshte vleresuar pozitivisht ne heshtje.. Me riblerjen e kuotes ose te pjeses se kuotes nga ana e shoqersie si me siper dhe me heqjen dote nga pjesa apo e gjithe kuota e kapitalit ortaku humbet te gjitha te drejtat e ti si i tille ose vijon te mbetet ortak ne masen qe asambleja vlereson qe ka fituar te drejtat si ortak. Kuotat e riblera do te jene ne pronesi te shoqerise dhe mund te perdoren ose ne rast shitjeje se nje apo disa ortakeve ekzistues ose te rinj ose mund te anulohen duke u mbuluar perpjestimisht nga ortaket ekzistues. Keto kuota te riblera nuk kane te drejte vote per sa kohe qe nuk jane emetuar. Kjo e drejte e shoqerise perfundon me mbarimin e afatit 40 mujor nga data e njohjes se te drejtave te tyre si ortake te saj.


NENI 9

Burimet te tjera te financimit



Shoqeria prevec kontributeve te kapitalit nga ortaket e saj mund te perdore dhe cdo burim tjeter financimi te fituar ne perputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi.

Ortaket X, ortaku Y, ortaku Z, dhe ortake B do te japin nje financim ne formen e huas perkatesisht ne nje shume minimale prej \$60,000 USD (gjashte dhjete mije dolare amerikane - USD), ortaku Y prej \$60,000, ortaku Z prej \$60,000, dhe ortaku B prej 6,000 USD. Ky financim do te jepet kundrejt nenshkrimt te kontrates perkatese midis tyre dhe shoqerise dhe me norma interesi sa interei i kredise me 5 perqind ne vite.. Shuma e ketij financimi mund te kerkohet me pjese bazuar ne nevojat e



shoqërise për fonde për funksionimin e saj, dhe do të jete me afat 40 muaj. Shoqëria nuk mund të shpërnda dividende nga fitimet e saj, pa shlyer me pare detyrimet ndaj këtyre ortakëve për financimin e marre prej tyre ose pa marre me pare pelqimin e te pakten 69% te ortakëve.

Nese ortakët X, Y, nuk e plotesojne detyrimin e tyre, atehre ata detyrohen te heqin dore nga 4/5 te kuotes se tyre te kapitalit te tyre ne perpjestim me mosplotesimin e ketij detyrimi, duke ja transferuar kete pjese te kuotes se tyre shoqërise me vleren nominale.

Nese ortakë Z, nuk e ploteson detyrimin e tij për te dhene shumen e financimit, atehre ai detyrohet te heq dore nga e gjithë kuota e tij e kapitalit te tij ne perpjestim me mosplotesimin e ketij detyrimi për dhenien e huas, duke ja transferuar kete pjese te kuotes se tyre shoqërise me vleren nominale.

NENI 9

Menyra e funksionimit te shoqërise

Shoqëria do te funksionojë si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në baze te statutit te shoqërise i cili hartohet mbështetur dhe në ne baze te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" si dhe do të zbatohet ligjin 9723 date 03.05.2007 "Për Qendren Kombetare te Regjistrimit" si dhe të legjislacionit tjetër në Shqipëri.

NENI 10

Organet drejtuese te shoqërise

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat 5 vjet nga regjistrimi ne QKB, me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë do të jetë Z. **Ilir Mitrushi**. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori,


NENI 11

Të tjera

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj. Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statuti.

NENI 12

Ruajta e sekretit



5

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 1.3

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 1.4

Nënshkrimi

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejte.

NENI 1.5

Dispozita te fundit

Kjo kontrate per themelimin e shoqerise hartohet ne gjuhën Shqipe dhe ne 5 kopje te barabarta.

[Handwritten signatures and a page number '6' at the bottom of the document.]



ORTAKET THEMELUES

A ILIR MITRUSHI

Emer mbiemer

'A' Emer mbiemer

Firm

[Handwritten signature]

'B' Emer mbiemer

Dritan Vullata

Firm

[Handwritten signature]

'X' Emer mbiemer

RUSSEL GRAW VAN CURE

Firm

[Handwritten signature]

'Y' Emer mbiemer

Migena Schroeder

Firm

[Handwritten signature]

'Z' Emer mbiemer

Axel Schutz

Firm

[Handwritten signature]

Perkthyes

Teqiana Dade

